

R A P O R T

Përkitazi me lëndët penale të korrupsionit, për periudhën nëntëmuajore të vitit 2011 (janar – shtator 2011)

Prokurorit Komunale dhe Prokurorit e Qarkut, gjatë periudhës janar – shtator 2011, kanë pasur në punë 662 kallëzime penale me 994 persona. Nga kallëzimet penale të cilat kanë qenë në punë, 223 ose 33,7% të kallëzimeve janë përcjell nga viti paraprak si të pazgjedhura, kurse 439 ose 66,3% janë raste të cilat janë pranuar në punë gjatë periudhës raportuese.

Nga numri i kallëzimeve penale që kanë qenë në punë, 435 ose 65,7% kanë qenë kallëzime penale nga regjistri PP, kurse 227 ose 34,3% kanë qenë raste nga regjistri PPN, çka do të thotë se numri i kallëzimeve në fjalë, në prokurori janë paraqitur si informata, e pas hetimeve të bëra është zbuluar se këto informata kanë të bëjë me vepra penale.

Gjatë periudhës raportuese, Prokurorit Komunale dhe të Qarkut, kanë zgjedh 341 ose 51,5% të kallëzimeve penale me 493 persona, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbet të pazgjedhura 321 ose 48,5% të kallëzimeve penale me 501 persona.

Nga lëndët e pazgjedhura, 198 ose 61,7% i përkasin regjistrin të PP dhe 123 ose 38,3% i përkasin regjistrin të PPN.

Nga rastet e gjithmbarshme të cilat kanë qenë në punë gjatë periudhës raportuese, 348 ose 51,3% me 510 persona u përkasin Prokurorive Komunale, kurse 314 ose 48,7% me 484 persona u përkasin Prokurorive të Qarkut.

Rastet e zgjidhura, gjatë nëntëmuajorit 2011, kanë përfunduar si në vijim:


- ◆ *Për 105 raste ose 30,8% me 134 persona, është hedhur kallëzimi penal,*
- ◆ *Për 62 raste ose 18,2% me 90 persona, është ngrit propozim akuza,*
- ◆ *Për 54 raste ose 15,8% me 112 persona, është ngrit aktakuza,*
- ◆ *Për 21 raste ose 6,2% me 37 persona është pushuar procedura hetimore dhe*
- ◆ *Për 99 raste ose 29,0% me 120 persona rastet janë zgjedh në mënyrë tjetër¹⁾.*

Sa i përket zgjedhjes së kallëzimeve penale të korrupsionit, mund të thuhet se prokurorit ishin bukur efektive nga së koeficienti i zgjedhshmërisë së këtij lloji të kallëzimeve penale ishte 51,2%, kurse koeficienti i zgjedhshmërisë së kallëzimeve penale në përgjithësi, gjatë periudhës raportuese ishte 52,4% gati i njëjtë, e dihet se kallëzimet penale të korrupsionit janë shumë të ndërlikuara se pse në të shumtën e rasteve këto vepra penale kryhen në katër sy.

¹⁾ Dërgim në kompetencë, heqje dorë nga ndjekja penale, pezullimi hetimit, bashkim i procedurave

Grupi punues, për zgjedhjen e lëndëve të korrupsionit i përbërë nga prokurorët ka pasur vështirësi, deri sa është kompletuar, nga shkak i numrit të vogël të prokurorëve si dhe për shkak të nderlikueshmerisë së këtij lloji të lëndëve.

Mënyra e zgjedhjes së kallëzimeve penale, më së miri shihet nga pasqyrimi grafik si në vijim:



Vlen për tu cekur së PPK në Prishtinë në bazë të numrit të kallëzimeve penale është dashur që ti ketë 20 prokuror e ajo tani i ka 14 prokuror, PPQ në Prishtinë duhet ti ketë 19 prokuror e deri para një muaji i ka pasur 8 prokuror.

Përveç kësaj Prokurorit ende nuk kanë hapësira të mjaftueshme të punës, PPK dhe PPQ Mitrovicë ende punojnë në dy zyre të cilat ua ka huazuar Gjykata Komunale në Vushtrri, Peja, Ferizaj, dhe Gjlani ende nuk kanë hapësira adekuate.

Struktura e personave të përfshirë në veprat penale të korrupsionit dukët si në vijim:

- *Me veprën penale, shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit-neni 339 i KPK, janë të përfshirë 835 ose 84,0% të personave;*
- *Me veprën penale, përovetësimi gjatë ushtrimit të detyrës -neni 340 i KPK-së, janë të përfshirë 38 ose 3,8% të personave;*
- *Me veprën penale, përdorimi i paautorizuar i pasurisë -neni 342 i KPK-së, janë të përfshirë 6 ose 0,6% të personave ;*
- *Me veprën penale, marrja e ryshfetit -neni 343 i KPK-së, janë të përfshirë 39 ose 3,9% të personave;*

- *Me veprën penale,dhënia e ryshfetit -neni 344 i KPK-së, janë përfshirë 22 ose 2,2% të personave;*
- *Me veprën penale,ushtrimi i ndikimit -neni 345 i KPK-së, janë përfshirë 2 ose 0,2% të personave dhe*
- *Me veprën penale, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore - neni 346 i KPK-së, janë përfshirë 52 ose 5,2%.*

Nga struktura e të dyshuarve për veprat penale të korrupsionit, shihet së 84,0% të personave janë të përfshirë me veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit .

Struktura e veprave penale e paraqitur grafikisht dukët si në vijim:

